



REPUBLIKA E KOSOVËS
ZYRA E AUDITORIT TË PËRGJITHSHËM

Nr. i Dokumentit: 21.20.1-2015-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE TË ADMINISTRATËS TATIMORE
TË KOSOVËS
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2014

Prishtinë, Qershor 2015

Zyra e Auditorit të Përgjithshëm kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës. Auditori i Përgjithshëm në Detyrë është kreu i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm, i cili ka rreth 145 të punësuar. Auditori i Përgjithshëm dhe Zyra e Auditorit të Përgjithshëm janë të pavarur dhe çertifikon rreth 90 Pasqyra Vjetore Financiare çdo vit, derisa ndërmarrin edhe forma të tjera të auditimit.

Misioni ynë është që të kontribuojmë në menaxhim të shëndoshë financiar në administratë publike. Ne do të kryejmë auditime cilësore në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik dhe praktikat e mira evropiane. Ne do të ndërtojmë besim në shpenzimin e fondeve publike. Ne do të luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe palëve tjera të interesit në rritjen e llogaridhënies publike.

Raportet e nxjerra nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien pasi që ato ofrojnë bazë për ti kërkuar llogari menaxherëve të çdo organizate buxhetore.

Auditori i Përgjithshëm në Detyrë ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit dhe raportin mbi Pasqyrat Vjetore Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës në konsultim me Asistent Auditorin e Përgjithshëm, Ibrahim Gjylderren, i cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti dhe opinionin i lëshuar janë rezultat i auditimit të kryer nën menaxhimin e Drejtorit të Auditimit, Vlora Mehmeti, i mbështetur nga, Jusuf Kryeziu (Udhëheqës Ekipi), Besa Morina dhe Saranda Husaj.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia	6
2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	8
3 Rekomandimet e vitit paraprak.....	10
4 Qeverisja.....	11
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP	26
Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak	29

Përmbledhje e përgjithshme


Hyrje

Ky raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi ynë i Pasqyrave Vjetore Financiare të Administratës Tatimore të Kosovës për vitin 2014 – i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Unë do të doja të falënderoja Drejtorin e Përgjithshëm dhe stafin e tij për ndihmën e tyre gjatë procesit të auditimit.

Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2014 u ndërmor në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtarisht të auditimit në Sektorit Publik (SNISA) të nxjerra nga INTOSAI. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ne menduam se ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e ndërmarrë është paraqitur në Memon e Planifikimit të Auditimit, e datës 03 Nëntor 2014.

Administrata Tatimore e Kosovës është agjenci ekzekutive e Ministrisë së Financave. Pasqyrat Vjetore Financiare të saj inkorporohen në kuadër të Pasqyrave Vjetore Financiare të Ministrisë së Financave. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm nuk është e obliguar që të kryej një auditim të veçantë të PVF-ve të ATK-së. Mirëpo, për shkak të natyrës dhe aktivitetit të ATK-së dhe si një shërbim ndaj nevojës së Komisionit për Mbikëqyrje të Financave Publike, ne kemi audituar PVF të ATK-së ndarazi nga auditimi i PVF -ve të MF-së.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Niveli i punës së kryer nga Zyra e Auditorit të Përgjithshëm për të përfunduar auditimin për vitin 2014 pasqyron drejtpërsëdrejti cilësinë e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti.

Opinion


Shtojca I shpjegon llojet e ndryshme të opinionëve të aplikuar nga ana e Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm është:

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë një *pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale (**ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar**)

Konkluzioni i përgjithshëm

Konkluzionet dhe rekomandimet tona kryesore janë:



Përgjigje nga Menaxhmenti - auditimi i vitit 2014

Menaxhmenti është pajtuar me të gjeturat tona të auditimit dhe është zotuar se do të adresoj rekomandimet tona.

1 Fushëveprimi i auditimit dhe metodologjia

Është përgjegjësi e Administratës Tatimore të Kosovës (ATK) të përgatisë Pasqyrat Vjetore Financiare (PVF) sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik (SNKSP) për “Raportimin Financiar në bazë të Kontabilitetit të Parasë së Gatshme” dhe kërkesave të tjera specifike. Zyra e Auditorit të Përgjithshëm (ZAP) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare si dhe të shprehemi:

- Nëse PVF japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Ne kemi shqyrtuar kontrollet menaxheriale, për të përcaktuar shkallën deri ku mund të mbështetemi në to, për përcaktimin e testimit të hollësishëm, i cili është i nevojshëm për të siguruar nivelin e nevojshëm të dëshmimeve, për të mbështetur opinionin e Auditorit të Përgjithshëm (AP). Aktivitetet e menaxhmentit përcaktojnë edhe fokusin e auditimit tonë të pajtueshmërisë dhe auditimit të qeverisjes së mirë të cilat nuk kanë ndikim të drejtpërdrejtë në opinion.

Qasja jonë audituese ndaj qeverisjes fokusohet në vlerësimin e veprimeve të ndërmarra nga menaxhmenti me qëllimin për të siguruar menaxhim efektiv financiar dhe kontroll, si dhe në vlerësimin e rezultateve të këtyre veprimeve në dhënien efikase të outputeve cilësore operacionale. Kjo, për shembull, mund të jetë një aktivitet monitorimi i ndërmarrë nga menaxhmenti ose nga nivele më të ulëta të kontrolleve operacionale. Ne konsiderojmë nëse kontrollet janë të dizajnuara mirë, nëse janë implementuar sipas planit dhe nëse operojnë në mënyrë efektive. Kjo kërkon një vlerësim të strukturave, proceseve dhe linjave të llogaridhënies të prezantuara nga menaxhmenti, përfshirë këtu edhe rolin e Auditimit të Brendshëm dhe të Komitetit të Auditimit si dhe kontrollet e brendshme të sistemit.

Pjesët e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të të gjeturave tona të auditimit me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit. Një vlerësim i mënyrës se si Menaxhmenti i ka adresuar rekomandimet e bëra në vitin 2013 mund të gjendet në Shtojcën II.

Për të qenë më i plotë, ne kemi përfshirë çështjet e identifikuar gjatë auditimit të ndërmjetëm aty ku ato kanë mbetur relevante. Në fazën e auditimit të ndërmjetme ne ofrojmë këshilla me qëllim që të mundësojmë ndërmarrjen e veprimeve përkatëse para prodhimit të PVF-ve dhe para auditimit final.

Të gjeturat tona janë definuar si:

Të prioritetit të lartë - Çështje të cilat mund të rezultojnë në dobësi materiale në kontrollin e brendshëm dhe ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme; dhe

Të prioritetit të mesëm - Çështje të cilat mund të mos rezultojnë në dobësi materiale, por ku veprimi i marrë do të ofrojë mundësinë për përmirësimin e efikasitetit dhe efektivitetit të kontrolleve të brendshme.

Të gjeturat që konsiderohen si me prioritet të ulët do të raportohen veçmas stafit të financave.

Procedurat tona kanë përfshirë një rishikim të kontrolleve të brendshme dhe sistemeve të kontabilitetit dhe teste substanciale të shoqëruara me to vetëm deri në atë masë që konsiderohet e nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen sikur përfaqësojnë një pasqyrë gjithëpërfshirëse të gjitha dobësive të cilat ekzistojnë, apo edhe të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë funksionuar.

2 Pasqyrat vjetore financiare dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Përshkrimi

Rishikimi ynë i PVF merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të regjistruar në pasqyrat financiare. Ne gjithashtu e marrim parasysh deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ (ZKA) dhe Zyrtari Kryesor Financiar (ZKF), kur draft PVF-të të dorëzohen në Qeveri.

Deklarata në lidhje me prezantimin e PVF përfshin një numër të pohimeve për sa i përket pajtueshmërisë me kornizën raportuese dhe cilësinë e informacionit në kuadër të pasqyrave financiare. Disa deklaratë kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një auditim gjithëpërfshirës.

Konkluzioni i përgjithshëm

ATK ka arritur të dorëzoj me kohë të gjitha raportet të cilat kërkohen me kornizën e aplikueshme ligjore. PVF-të kanë përmbushur të gjitha kërkesat e SNKSP "Raportimi Financiar sipas Kontabilitetit të Parasë së Gatshme" dhe Rregullës Financiare nr. 03/2013. Cilësia e PVF në përgjithësi ishte e mirë. Të gjitha obligimet e tjera të raportimit të jashtëm që nuk kanë lidhje me PVF ishin përmbushur plotësisht.

2.1 Opinioni i Auditimit

Sipas opinionit tonë pasqyrat financiare prezantojnë *një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.

(ISSAI 200/1700 Opinion i Pamodifikuar)

2.2 Pajtueshmëria me PVF dhe kërkesat tjera për raportim

Përshkrimi

ATK duhet të jetë në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregullës Financiare nr. 03/2013;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048;
- Kërkesat e buxhetit;
- Raportet tremujore, duke përfshirë pasqyrat financiare nëntë mujore;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve të auditimit;
- Plani preliminar dhe final të prokurimit;
- Raportet për borxhet e papaguara; dhe
- Raportet e progresit për projektet kapitale me vlerë mbi 10,000€.

Në kontekst të PVF-ve dhe obligimeve tjera për raportim të jashtëm, ne nuk kemi asnjë çështje për të ngritur në lidhje me këto.

Marrë parasysh atë më lart - Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF, me dorëzimin e draft PVF-ve në Qeveri, mund të konsiderohet e drejtë dhe e vërtetë.

Rekomandimi

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3 Rekomandimet e vitit paraprak

Konkluzioni i përgjithshëm

Që prej pranimit të rekomandimeve tona në korrik 2014 për vitin 2013, ATK ka ndërmarrë masa për t'i adresuar shqetësimet e ngritura. Megjithatë, përkundër progresit edhe më tutje mbetin shumë çështje për t'u adresuar.

Përshkrimi

Raporti jonë i auditimit për PVF-të e vitit 2013, ka rezultuar me 13 rekomandime. ATK ka përgatitur një Plan Veprimi për të siguruar se të gjitha rekomandimet adresohen brenda periudhës së specifikuar.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2014, tri (3) rekomandime janë adresuar plotësisht, katër (4) pjesërisht, përderisa gjashtë (6) nuk janë adresuar ende. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë adresuar ato, shihni Shtojcën II.

Rekomandimi

Çështja 1 - Adresimi i rekomandimeve nga viti paraprak – Prioritet i lartë

- | | |
|----------------------|--|
| E gjetura | ATK nuk ka arritur të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për adresimin e plotë të rekomandimeve të AP-së. Si pasojë mangësitë e njëjta janë përsëritur në fushën e planifikimit dhe realizimit të buxhetit për kapitale, menaxhimit të pasurisë, pagesën e pagave të punonjësve, shpenzimet e telefonisë mobile, si dhe menaxhimin dhe inkasimin e të arkëtueshmeve. |
| Rreziku | Dobësitë e vazhdueshme të kontrolleve të menaxhmentit dhe kontrolleve tjera në sistemet kyçe financiare dhe të kontrollit kanë rezultuar në mangësi të dukshme të cilat mund të ndikojnë në efikasitetin e organizatës në tërësi. |
| Rekomandimi 1 | Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se masat e përcaktuara në planin e veprimit për fushat me mangësi të theksuara rishikohen dhe monitorohen në vazhdimësi për të siguruar që ato zbatohen plotësisht nga stafi llogaridhënës gjatë kryerjes së aktiviteteve të përditshme. |

4 Qeverisja

Konkluzioni i përgjithshëm

Aspektet kyçe të kornizës së qeverisjes janë adresuar nga ATK si në vazhdim:

- Vetëvlerësimi siç kërkohet me procedurat për menaxhimin financiar dhe kontrollin;
- Menaxhimi i rrezikut në përputhje me objektivat strategjike të ATK-së i përshkruar në planin strategjik;
- Raportimi i brendshëm dhe kontrollet menagjeriale; dhe
- Sistemi i auditimit të brendshëm.

Meqenëse, ATK është organizata më e madhe në gjenerimin e të hyrave pas Doganës kontrollet mbi të hyrat në përgjithësi janë të forta dhe po zbatohen në mënyrë efektive, megjithatë veprime shtesë kërkohen për avancimin e mëtutjeshëm të kontrolleve në mbledhjen e të hyrave.

Përderisa, kontrollet mbi një sërë fushash tjera të shpenzimeve duhet të rishikohen dhe veprime konkrete të ndërmerren në mënyrë që të parandalojnë anashkalimin e kërkesave ligjore dhe menaxhimin jo efektiv të parasë publike. Fushat kryesore në të cilat nevojiten më shumë përmirësime janë procesi buxhetor lidhur me investimet kapitale, menaxhimi i borxheve (të arketueshmet), menaxhimi i pasurisë dhe menaxhimi i shpenzimeve.

4.1 Planifikimi dhe realizimi i Buxhetit

Përshkrimi

Në i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore për ATK, shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike dhe të hyrat e inkasuara. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore - realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Burimet e Fondeve:	9,138,297	8,390,207	8,081,655	7,616,788	7,426,107
Granti i Qeverisë -Buxheti	9,138,297	8,390,207	8,081,655	7,616,788	7,426,107

Buxheti final krahasuar me buxhetin fillestar është më i vogël për 748,090€. Zvogëlimi është zbatuar me vendime të Qeverisë.

Në vitin 2014, ATK ka realizuar rreth 96% të buxhetit final ose 8,081,655€. Në përgjithësi ekzekutimi i buxhetit për vitin 2014 mbetet në nivel të kënaqshëm.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike- realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Realizimi	2013 Realizimi	2012 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	9,138,297	8,390,207	8,081,655	7,616,788	7,426,107
Pagat dhe Mëditjet	5,472,556	6,151,283	6,151,283	5,385,023	5,257,739
Mallrat dhe Shërbimet	1,492,000	1,268,200	1,253,266	1,571,764	1,559,917
Shërbimet komunale	198,200	238,572	202,361	229,676	209,459
Investimet Kapitale	1,975,541	732,152	474,746	430,325	398,992

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë në dhënë si në vijim:

Buxheti për Paga dhe Mëditje është rritur për 678,727€. Buxheti për këtë kategori për 2014 është shpenzuar 100%.

Buxheti final për Mallra dhe Shërbime në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 223,800€ si rezultat i vendimit të Qeverisë për shkurtime buxhetore prej 15%. Buxheti final për këtë kategori është realizuar rreth 99%.

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi që është e përshtatur vazhdimisht nga Ministria e Financave

Buxheti final për komunal në raport me buxhetin fillestar është rritur për 40,372€. Buxheti final është realizuar rreth 85%.

Buxheti final për investime kapitale në raport me buxhetin fillestar është zvogëluar për 1,243,389€, projekti “Sistemi i ri bazë i tatimeve” në vlerë prej 1,215,541€ është larguar nga buxheti i vitit 2014 sepse që nga 2013 nuk është iniciuar ndonjë aktivitet. Buxheti për këtë kategori është realizuar rreth 65% i cili është në nivel jo të kënaqshëm. Investimet Kapitale kryesisht janë realizuar në sektorin e teknologjisë informative.

Tabela 3. Të hyrat e inkasuara për buxhetin e Kosovës – realizimi ndaj buxhetit (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2014 Pranimet	2013 Pranimet	2012 Pranimet
Të hyrat	367,000,000	367,000,000	303,694,991	305,447,912	283,914,603
Kthimet	(34,800,000)	(34,800,000)	(31,108,083)	(34,684,540)	(32,741,722)
Totali	332,200,000	332,200,000	272,586,908	270,763,372	251,172,881

Të hyrat bruto të planifikuara nga ATK për vitin 2014 ishin 367,000,000€. Përderisa realizimi i tyre ishte 303,694,991€, apo 83% të kuotës së planifikuar të të hyrave.

Pavarësisht që ATK, nuk e ka realizuar planin plotësisht, nga trendi i të hyrave vërehet se ka një ngritje të të hyrave neto në raport me vitin paraprakë për 1,823,536€. Të hyrat bruto krahasuar me vitin 2013i kishte më të ulëta për 1,752,921€.

Në vitin 2013, ATK nuk kishte arritur të përmbush planin e kontrolleve, përderisa në vitin 2014 ATK ka treguar progres në këtë drejtim duke e tejkaluar këtë plan.

Çështja 2 – Realizimi i buxhetit për investimet kapitale – Prioriteti i Lartë

- E gjetura** Edhe pse në përgjithësi ishte një nivel i mirë i realizimit të buxhetit, realizimi i buxhetit në investime kapitale mbetet në nivel jo të knaqshëm. Edhe përkundër shkurtimeve buxhetore që janë bërë në këtë kategori, realizimi i tyre mbetet jo në nivelin e pritur. Një ndër shkaqet e mos realizimit ishte edhe nënshkrimi i kontratave për dy projekte kapitale në dy mujorin e fundit të 2014.
- Rreziku** Ekzekutimi i buxhetit në nivelin jo të pritur dhe mos përmbushja e planit në për investime kapitale mund të rezultojë në mos arritjen e objektivave të organizatës dhe uljen e efikasitetit të ATK-së.
- Rekomandimi 2** Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka analizuar trendin historik të buxhetit për projekte kapitale dhe ka ndërmarr masa për përmirësim. Po ashtu, për të rritur realizueshmërinë e buxhetit për projekte kapitale ka analizuar mangësitë në procesin e buxhetimit për evitimin e tyre në të ardhmen.

Çështja 3 - Paguesa e pagave nga programet e tjera të MF-së - Prioritet i lartë

- E gjetura** Sipas Ligjit të buxhetit për vitin 2014 dhe sipas planit të rrjedhës së parasë së gatshme, planifikimi i pagave në raport me 1/12 e totalit të mjeteve të aprovuara për paga dhe mëditje nuk e mbulon shpenzimin për pagën mujore. Kjo gjendje ka ardhur për shkak se buxheti i aprovuar për këtë kategori ishte nën kërkesat reale të ATK-së.
- Si pasoj e kësaj, ATK për çdo muaj ka mungesë të mjeteve për paga dhe mëditje dhe kjo mungesë e buxhetit është financuar nga një program tjetër i MF-së.
- Gjendja e njëjtë është duke u përsëritur që nga viti 2009 dhe ka vazhduar të jetë po kjo gjendje edhe në vitin 2015. Edhe pse kjo çështje është ngritur si në raportin e auditimit të lëshuar nga ZAP ashtu edhe nga zyrtarët e ATK-së, MF nuk e ka marrë në konsideratë asnjëherë.
- Rreziku** Mungesa e buxhetit mund të shkaktoj ngecje në realizimin e objektivave të ATK-së dhe mund të shkaktoj obligime të pagave për të punësuarit.
- Rekomandimi 3** Drejtori i Përgjithshëm duhet të inicioj diskutimet me Ministrin e Financave për të siguruar që buxheti për vitet e ardhshme aprovohet në bazë të kërkesave reale të dorëzuara nga ATK me qëllim që financimi i pagave të bëhet në mënyrë transparente.

4.2 Të hyrat

Përshkrimi

Të hyrat e gjeneruara nga ATK në vitin 2014 ishin në total 272,586,908€. Në raport me vitin e kaluar, ATK ka shënuar realizim më të lartë të të hyrave për 1,823,535€ apo 0.67%. Rritje më të madhe tregohet tek tatimi i pagave i mbajtur në burim, tatimi për biznese individuale, tatimi i mbajtur në burim, interesa, e drejtë pronësore dhe qira. Në vijim do të paraqesim në mënyrë të detajuar të hyrat dhe kthimet për vitin 2014.

Tab. 4 të hyrat e detajuara sipas llojit dhe kthimet (Janar-Dhjetor/2014).

Nr.	Përshkrimi	Vlera në Euro
1	Konto kaluese - administrata tatimore	(42,071.07)
2	Kthimi i tatimit mbi vlerën e shtuar	30,699,309.54
3	Kthim-tatimi per biznese	196,727.36
4	Kthim-tatimi per korporata	87,626.73
5	Kthim-tax ne paga - mbajtur në burim	123,419.46
6	Kthim-te hyrat nga gjobat e ATK-se	1,000.00
7	Licencat për lojëra	(5,000.00)
8	Tatim mbajtur burim, interesa, drejta pronësore dhe qira	(10,431,620.97)
9	Tatim mbi qira, pasuri patrupëzuar	(1,764,888.01)
10	Tatimi i pagave i mbajtur në burim	(67,419,447.61)
11	Tatimi I paragjykuar	(156,814.19)
12	Tatimi mbi vlerën e shtuar	(135,786,826.21)
13	Tatimi në fitim	(15,412.78)
14	Tatimi për biznese individuale	(30,945,458.09)
15	Tatimi për korporata	(54,946,751.90)
16	Të hyrat nga shitja e mbeturinave	(765.00)
17	Te hyrat nga shitja e mallrave të konfiskuara	(32,667.20)
18	Tëhyrat nga gjobat e administratës tatimore të Kosovës	(1,878,327.06)
19	TVSH-ja e shtyrë	(268,940.72)
Totali i të hyrave për vitin 2014		(272,586,907.72)

Ne kemi ekzaminuar 100 mostra (teste thelbësore), kryesisht në të hyrat nga: Tatimi mbi vlerën e shtuar, Tatimi për korporata, Tatimi për biznese individuale, Tatimi i pagave i mbajtur në burim dhe Tatimi mbi qira, si dhe kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë për disa mostra. Përveç kësaj, kemi ekzaminuar kthimet e tatimit mbi vlerën e shtuar, dhe kemi marrë listën e bizneseve që janë jo - aktive dhe nuk i përgjigjen ATK-së dhe i kemi verifikuar nëse këto biznese kryejnë punë/shërbime në institucione të financuara nga buxheti i shtetit. ATK në përgjithësi ka një sistem funksional në menaxhimin e të hyrave, përveç disa mangësive të cilat janë të prezantuara në vijim:

Çështja 4 - Mos inkasimi i të hyrave nga Bizneset jo-aktive -Prioritet i Lartë

- E gjetura** Ne kemi analizuar listën e bizneseve që janë jo-aktive përkatësisht listën e bizneseve të cilat nuk i përgjigjen ATK-së në kryerjen e obligimeve tatimore dhe si rezultat i kësaj doli që disa biznese të kësaj liste kanë përfituar kontrata për punë dhe shërbime nga Buxheti i Kosovës. Ky është indikator që këto biznese gjenerojn të hyra dhe krijojn fitim përderisa janë të papërgjegjshme ndaj kryerjes së obligimeve ligjore ndaj shtetit.
- Rreziku** Kjo rritë rrezikun e humbjes (mos mbledhjes) së të hyrave nga këto biznese dhe ndikon në performancën e ATK-së lidhur me inkasimin e të hyrave në përgjithësi.
- Rekomandimi 4** Drejtori i Përgjithshëm përveq që ka siguruar te dhëna adekuate per bizneset jo aktive duhet të shqyrtoj edhe mekanizmat ligjorë për grumbullimin e të hyrave nga këto biznese.

Çështja 5 - Mos harmonizim i të dhënave për rimbursimet mes Thesarit dhe ATK-së - Prioritet i Lartë

- E gjetura** Në vitin 2014, kërkesat nga tatimpaguesit për rimbursime ishin 32,497,078€. Si rezultat i shqyrtimit të këtyre kërkesave nga ATK, ishin refuzuar kërkesa në vlerë prej 830,056€ përderisa ishin aprovuar kërkesa në vlerë prej 31,667,022€. Nga vlera e aprovuar 27,304,418€ janë transferuar në llogarit e tatimpaguesve të cilët kanë parashtruar kërkesën për rimbursim kurse pjesa tjetër (4,362,603€) i`u është ndalur në emër të obligimeve të cilët kishin ndaj ATK-së. Të dhënat e prezantuara në PVF për rimbursimin e tatimit mbi vlerën e shtuar janë në vlerë prej 30,699,309€. Pra vlerat e rimbursimeve sipas të dhënave të ATK-së janë më të mëdha se në Thesar. Kjo çështje është shpalosur edhe në Pasqyrat Vjetore Financiare të ATK-së.
- Rreziku** Ndryshimet në informata mes Thesarit dhe ATK-së vënë në dyshim besueshmërinë e të dhënave të raportuara.
- Rekomandimi 5** Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj masat për identifikimin e shkaktarëve për të dhënat jo konsistente dhe eliminimin e tyre në mënyrë që të sigurohet harmonizimi I të dhënave lidhur me rimbursimet.

Çështja 6-Vonesa në rishqyrtimin e rimbursimeve – Prioritet i mesëm

- E gjetura** Sipas Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat, neni 30 pika 4, ATK duhet të veproj lidhur me kërkesën e aprovuar për rimbursim brenda 60 ditëve nga data kur ka pranuar kërkesën nga tatimpaguesi. Nëse rimbursimi nuk zbatohet brenda periudhës kohore, atëherë ATK përveç rimbursimit, tatimpaguesit duhet paguar edhe interesin.
- ATK ka treguar progres në shqyrtimin e rimbursimeve krahasuar me vitet e kaluara, megjithatë gjatë testimit të mostrave për rimbursim, në një rast kemi vërejtur se kishte vonesë në rishqyrtim të rimbursimit.
- Rreziku** Vonesat në rimbursime ndikojnë në efikasitetin e zbatimit të legjislacionit dhe mund të rezultoj me pagesa të interesit nga ana e ATK-së ndaj tatimpaguesit.
- Rekomandimi 6** Drejtori i Përgjithshëm duhet të shtoj kontrollet për të siguruar që kërkesa e tatimpaguesve të aprovuara për rimbursim të shqyrtohen brenda afatit të përcaktuar kohor.

4.3 Shpenzimet

ATK ka të dizajnuar sistemin e kontrollit të brendshëm, si dhe funksionon në përputhje me atë me përjashtim të disa dobësive të cilat ekzistojnë sa i përket procedurave të shpenzimeve në Prokurim dhe tek kategoria e Pagave dhe Meditje.

4.3.1 Prokurimi

Përshkrimi

Shpenzimet totale të ATK-së përmes procedurave të prokurimit janë në vlerë prej 1,728,012€. Ne kemi testuar 13 pagesa nga mallrat dhe shërbimet, si dhe pesë pagesa nga investimet kapitale.

Po ashtu, për të vlerësuar pajtueshmërinë e procedurave të prokurimit me Ligjin e Prokurimit Publik ne kemi testuar 15 aktivitete të prokurimit. Në përgjithësi në ATK kontrollet kanë funksionuar në mënyrë efektive, megjithatë janë disa mangësi të cilat duhet të adresohen për ta përmirësuar procesin në tërësi.

Çështja 7 - Zgjatja e kontratës publike kornizë përtej afatit ligjor - Prioritet i lartë

E gjetura ATK ka vazhduar të marrë shërbime nga i njëjti Operator Ekonomik (OE) tre muaj përtej afateve ligjore. Kontrata “Sigurimi fizik i objekteve sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së” kontratë e cila ishte nënshkruar në Korrik të vitit 2011 në kohëzgjatje prej dy vite me mundësi vazhdimi edhe për një vit me pajtimin e të dyja palëve. Bazuar në këtë kontratë, të njëjtit OE i është vazhduar kontrata edhe për një vit.

Më tej, pas këtij afati prej tre vite, autoriteti kontraktues me procedurë të negocuar pa publikim të njoftimit për kontratë, vazhdon kontratën me të njëjtin OE edhe për një muaj me mundësi vazhdimi për dy muaj radhazi, që gjithsej është vazhduar për tre muaj. Vlera e parashikuar tre mujore e shërbimeve është rreth 46,500€ ndërsa vlera mujore është rreth 15,500€. Mirëpo në muajin e dytë është nderpre kjo marrëveshje dhe shërbimet janë marrë nga operatori i ri i përzgjedhur.

Rreziku Lidhja e kontratave në vazhdimësi me të njëjtin operator e dëmton konkurrencën e lirë si dhe rrezikon arritjen e vlerës për para.

Rekomandimi 7 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që kontratat publike korniz nuk janë zgjatur përtej afatit ligjor.

Çështja 8 - Mangësi në procesin e prokurimit - Prioritet i lartë

E gjetura Tek aktiviteti i prokurimit “Servisimi, furnizimi i aparateve kundër zjarrit sipas kërkesave dhe nevojave të ATK-së” prej dy tenderëve të pranuar vetëm njëri ishte i përgjegjshëm. Përkundër kësaj, komisioni vlerësues ka rekomanduar dhe ATK ka shpërblyer me kontratë të vetmin OE të përgjegjshëm². Gjithashtu para nënshkrimit të kësaj kontrate, ATK ka pranuar depozitimin e sigurisë së ekzekutimit në vlerë prej 1,000€ e vlefshme për 25 muaj. Vlera e sigurisë së ekzekutimit nuk përbënë 10% të vlerës së kontratës.

Aktiviteti i prokurimit “Furnizim me pajisje të TI”, pjesë e së cilës ishte edhe kontrata e lartë shënuar, përbëhej nga gjashtë (6) Lot në vlerë prej 183,823€ dhe për secilin Lot ishte nënshkruar kontratë e veçantë. ATK nuk ka kërkuar siguri të ekzekutimit në asnjërin nga Lot, përveç për Lot 1.

² Çmimi i përgjithshëm i kësaj kontrate ishte në vlerë prej 2,572€ apo çmimin për njësi në vlerë prej 32€.

Rreziku Shpërblimi me kontratë në munges të operatorëve të përgjegjshëm është në kundërshtim me legjislacionin në fuqi dhe dëmton konkurrencën në përzgjedhjen e OE. Si dhe mos aplikimi i sigurisë së ekzekutimit të tenderit, mund të ndikojë në heqjen e përgjegjësisë ndaj kontraktuesit nga ana e OE.

Rekomandimi 8 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se ka shtuar kujdesin para nënshkrimit të kontratës për të siguruar operator të përgjegjshëm në përputhje me legjislacionin në fuqi. Po ashtu, me rastin e nënshkrimit të kontratës me OE paraprakisht të siguroj se është depozituar siguria e ekzekutimit e barabartë apo jo më pak se 10% e vlerës së kontratës.

Çështja 9 – Shpenzimet e telefonisë mobile pa procedurë të prokurimit publik – Prioritet i lartë

E gjetura Shpenzimet e telefonisë mobile për 2014 ishin në vlerë prej 133,000€, të cilat nuk ishin mbështetur nga një marrëveshje kontraktuale me ndonjë OE. Gjer më tani këtë lloj furnizimi ATK e ka bërë përmes blerjes së kartelave mbushëse (grithëse) nga PTK-VALA 900, duke u mbështetur në një vendim të nxjerrë nga ish Ministri i MEF-it nga data 29.04.2008 i cili vendim ishte mbështetur në Udhëzimet Administrative Nr 4/2008, për përdorimin e Telefonave (fiks dhe mobil).

Meqenëse, tani operojnë disa OE që ofrojnë shërbime të mira dhe çmime të favorshme, mënyra aktuale e furnizimit me mbushje të telefonave nuk i siguron ATK-së shërbime efikase dhe ekonomike.

Rreziku Realizimi i shpenzimeve të telefonisë mobile pa procedura të prokurimit përveq që është në kundërshtim me legjislacionin, njëkohësisht e rrisin rrezikun për shpenzim jo racional të parasë publike.

Rekomandimi 9 Drejtori i Përgjithshëm duhet të shqyrtoj mundësin e zhvillimit të procedurave të prokurimit lidhur me shërbimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase me çmime më të favorshme.

Çështja 10- Përfshirja e shpenzimeve komunale në “Plan të Prokurimit” – Prioritet i mesëm

E gjetura Në plan të prokurimit janë përfshirë edhe shpenzimet për komunal si: shpenzimet për energji elektrike, ngrohja qendrore, për mbeturina, shpenzime të ujit dhe telefoni fikse me vlerë totale prej 213,000€.

Rreziku Monitorimi i pamjaftueshëm nga menaxhmenti në përgatitjen e planit të mirëfillt të prokurimit ka rezultuar me përfshirjen e shërbimeve komunale në planin e prokurimit. Kjo mund të shkaktoj paqartësi në ekzekutimin e planit të prokurimit.

Rekomandimi 10 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj vetëdijesim dhe monitorim të mjaftueshëm në përgatitjen e planit të prokurimit.

Çështja 11 - Vonesë në liferimin e mallrave nga operatorët ekonomik - Prioritet i Mesëm

E gjetura Në kontratën "Furnizim me Network Firewall "në vlerë prej 21,488.10€, OE kishte dështuar të përmbush kriterin për liferim të mallrave e cila kishte rezultuar me 55 ditë vonesë.

Gjithashtu edhe në kontratën "Furnizimi me pajisje të TI (printer, projektor, ups, bateri, hdd)" në vlerë prej 8,203€. Vonesa në liferim ishte për disa artikuj nga fletëporosia. Sipas kontratës, afati i liferimit ishte 30 ditë kalendarike nga fletëporosia. Vonesat ishin mbi 100 ditë.

Rreziku Vonesat në liferimin e mallit ndikon në uljen e përgjegjësisë nga OE në përmbushjen e afateve të kontraktuara e cila mund të rezultojë edhe me vonesë në realizimin e objektivave të organizatës.

Rekomandimi 11 Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që kontrollet e monitorimit janë vendosur për të siguruar që shërbimet apo furnizimet nga OE të përzgjedhur të realizohen brenda afatit kohorë të përcaktuar sipas kontratës.

4.3.2 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)

Përshkrimi

Pagat dhe Mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar. Kontrollet që operojnë në ATK kanë të bëjnë me autorizimin e Payroll-it, një analizim i variancave dhe harmonizimeve të ndryshme.

Numri i punëtorëve të aprovuar ishte 785 ndërsa numri i punëtorëve në fund të vitit 2014 ishte 784. Gjatë vitit 2014, ATK ka pasur 26 rekrutime të jashtme.

Ne kemi kryer procedura analitike dhe kemi testuar dymbdhjetë (12) mostra ku kemi kryer teste substanciale dhe gjashtë (6) mostra në të cilat kemi aplikuar teste të pajtueshmërisë.

Nga testimet tona kanë shpalosur të gjeturat si në vijim:

Çështja 12 - Mospërputhje në mes të koeficientit në akt emërim me koeficientin në payroll - Prioritet i lartë

E gjetura Në një rast, kemi vërejtur se kategoria funksionale (koeficienti), në aktemërim nuk është në përputhje me koeficientin dhe pagën e të punësuarit në payroll. Sipas zyrtarëve të ATK-së ekzistojnë edhe 47 raste të tjera të njëjta, ku koeficienti në kontratë nuk përputhet me pagat të cilat i marrin aktualisht këta punëtorë.

Kjo ka ardhur si rezultat i performancës së treguar gjatë vitit 2013, ku menaxhmenti i ATK-së ka aplikuar masa stimuluese dhe të avancimit të stafit duke ngritur nga gjysëm koeficienti në pagë (29.00€/muaj). Pasi që janë përgatitur dhe nënshkruar aktemërimet e reja, është bërë propozimi për vendosjen e ndryshimeve në paga, mirëpo të njëjtat (ndryshime) nuk janë aprovuar nga Ministria e Administratës Publike.

Rreziku Mospërputhshmëria e të dhënave në aktemërimet me payroll rrezikon besueshmërinë dhe legjitimitetin e aktit të emërimit.

Rekomandimi 12 Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që paraprakisht ka marr aprovimet e duhura nga autoritetet përkatëse për ngritje të pagave dhe më pas t'i reflektoj ndryshimet në aktë emërim.

Çështja 13- Mungon përshkrim i detyrave dhe përgjegjësive - Prioritet i mesëm

E gjetura Në të gjitha mostrat e testuara mungonte përshkrimi i duhur i detyrave dhe përgjegjësive të punësuarve. Në tri (3) raste zyrtarët nuk kishin fare përshkrim të detyrave dhe përgjegjësive. Ndërsa në dy (2) raste, zyrtarët kanë ndërruar pozitën e punës mirëpo, dosjet kanë të bashkangjitur detyrat dhe përgjegjësitë sipas pozitave të kaluara.

Sipas zyrtarëve të ATK-së, të punësuarit nuk kanë të përshkruar detyrat e punës mirëpo janë në proces të azhurnimit të dosjeve dhe krijimin e dosjeve të reja të personelit.

Rreziku Mos përshkrimi i detyrave dhe përgjegjësive të punësuarve mund të krijojë paqartësi dhe konfuzion lidhur me detyrat e punës tek të punësuarit duke ndikuar në performancën e tyre në punë.

Rekomandimi 13 Drejtori i Përgjithshëm duhet të inicioj procedurat për sigurimin e përshkrimeve të qarta të detyrave dhe përgjegjësive në Aktin e emërimit.

4.4 Pasuritë dhe detyrimet

4.4.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Përshkrim

Vlera e pasurive jo financiare kapitale (mbi 1,000€) e paraqitur në PVF ishte 2,348,000€, ndërsa vlera e pasurive jo kapitale (nën 1000€) ishte 295,000€ si dhe stoqet në vlerë prej 227,000€.

Ne kemi identifikuar mangësitë si në vijim:

Çështja 14 – Mangësi në Menaxhimin e Pasurive të ATK-së – Prioritet i lartë

E gjetura ATK e ka formuar komisionin për inventarizimin e pasurisë i cili e ka kryer inventarizimin dhe ka përgatitur raportin e inventarizimit. Mirëpo, nuk ka formuar komisionin për vlerësim të pasurisë i cili duhej kryer detyrat dhe përgjegjësitë në përputhje me legjislacionin në fuqi, konkretisht nuk është bërë vlerësimi i pasurisë.

Sipas rregullores për menaxhimin e pasurive, çdo organizatë buxhetore duhet mbajë regjistrin E-pasuria, për evidentimin e pasurive me vlerë nën 1,000€. ATK nuk ka funksionalizuar regjistrin E-pasuria, mirëpo ka një softuer të brendshme për evidentimin e pasurisë.

ATK nuk e ka hartuar Udhëzimin e Brendshëm për Inventarizimin dhe vlerësimin e pasurisë edhe pse kjo ishte rekomanduar nga ZAP edhe në vitin e kaluar.

Sipas rregullës së MF-së, nr.02/2013, pasuria nuk zhvlerësohet për muajin e blerjes. Mirëpo, në 20 mostra në blerjet e bëra në muajin dhjetor është aplikuar zhvlerësimi edhe për atë muaj.

Rreziku Kontrolllet e dobëta në menaxhimin e pasurisë kanë rezultuar me mangësi të shumta në këtë komponent të cilat e rrisin rrezikun ndaj humbjeve apo keqpërdorimit të tyre.

Rekomandimi 14 Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikoj kontrolllet ekzistuese në menaxhimin e pasurisë. Kontrolllet në këtë fushë duhet të forcohen në mënyrë që pasuritë të ruhen nga humbja keqpërdorimi.

4.4.2 Detyrimet e papaguara

ATK, ka shpalosur obligimet e papaguara në Pasqyrat Vjetore Financiare për vitin 2014 në përputhje me Rregullën Financiare nr. 02/2013/MF për Raportimin e Obligimeve të Papaguara të Organizatave Buxhetore. Vlera e obligimeve të shpalosura është 40,022€. Këto obligime janë bartur për t'u paguar në vitin 2015.

Në listën e faturave të papaguara kemi përzgjedhur shtatë mostra për ekzaminim, dhe si rezultat i ekzaminimit të këtyre mostrave doli që:

Çështja 15 - Rritja e obligimeve dhe mangësi në raportimin e tyre në Thesar – Prioritet i mesëm

E gjetura Pjesa më e madhe e obligimeve të papaguara i takojnë shpenzimeve të qirasë dhe shpenzimeve të derivateve për vetura dhe gjenerator. Obligimet e papaguara janë më të larta se buxheti i pashpenzuar për 2014 për mallra dhe shërbime. Buxheti i mbetur për mallra dhe shërbime është 14,934€. Nga kjo rezulton që ATK ka hyrë në obligime pa buxhet.

Më tej, ATK evidenton të gjitha faturat e papaguara si dhe i raporton në raportin mujor të faturave të papaguara, mirëpo në disa raste kemi vërejtur që evidentimi dhe raportimi ishte bërë me datën e lëshimit të faturës dhe jo të pranimit të saj nga ATK.

Rreziku Rritja e obligimeve të papaguara është indikator për menaxhim jo efikas të parasë publike për vitin fiskal dhe ndikon në buxhetin e vitit vijues. Po ashtu, hyrja në obligime në mungesë të buxhetit mund të rezultojë në pamundësinë e pagesës së tyre, si dhe mangësitë në paraqitjen e datave të faturës në raportin mujor të faturave ndikon në cilësinë e raportimit të obligimeve.

Rekomandimi 15 Drejtori i Përgjithshëm duhet të analizojë arsyet për rritjen e obligimeve dhe të sigurojë që faturat e papaguara të paguhen me kohë me qëllim që obligimet të mos ngarkojnë buxhetin e vitit vijues. Veç kësaj, në raporte mujore të obligimeve të prezantohen (raportohen) datat e krijimit të obligimit.

4.4.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve

Përshkrim

Sipas PVF-ve 2014, ATK ka shuma të pa arkëtuara të të hyrave në vlerë prej 277,823,490€. Përderisa, në fund të 2013 ishin 253,496,704€ në vitin 2014 këto borxhe janë rritur për 24,326,786€. Këto të arkëtueshme përbëhen kryesisht nga Tatimet, Ndëshkimet dhe Interesi. Gjatë vitit 2014 janë inkasuar borxhe në shumë 47.7 mil€, 10.03% më shumë se vitin e kaluar. Për vitin 2013 ATK kishte inkasuar 43.4 mil€. Edhe pse ATK ka treguar progres në inkasimin e të arkëtueshmeve krahasuar me vitin e kaluar si dhe ka krijuar një modul të posaqëm e cila ka ndikuar në këtë progres, megjithatë ne identifikua se:

Çështja 16 - Të hyrat e pa arkëtuara - Prioritet i lartë

- E gjetura** Edhe më tej, trajtimi i borxheve të vjetra dhe trendi i rritjes së borxheve të reja mbetet sfid për ATK-në. Mungesa e një analize për të identifikuar/nxjerrur shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve të caktuara nga ATK ose edhe mungesa e një mekanizmi për stimulim të bizneseve për pagesën e borxheve ka rezultuar me një inkasim të dobët të tyre.
- Rreziku** Borxhet e pa arkëtuara zvogëlojnë aftësinë e ATK-së në arkëtimin e tyre si dhe krijon rast precedent për debitorët e tjerë të cilët mund të vendosin të mos paguajnë.
- Rekomandimi 16** Drejtori i Përgjithshëm duhet të shqyrtojë vjetërsinë dhe vlefshmërinë e borxheve individuale dhe të zbatojë një proces sistematik të trajtimit të atyre borxheve që konsiderohen të pa mbledhshme. Të gjitha mjetet në dispozicion të shfrytëzohen, përfshirë veprimet ligjore. Gjithashtu të bëjë një analizë në mënyrë që të nxjerr shkaktarët e dështimit të bizneseve në pagesën e borxheve.

4.5 Sistemi i auditimit të brendshëm

Përshkrimi

Njësia e Auditimit të Brendshëm (NJAB) në ATK përbëhet nga Drejtori, dhe tre auditorë. Kjo njësi kryen aktivitetet e saj audituese sipas planit strategjik dhe atij vjetor dhe i raporton Komitetit të auditimit.

Komiteti i auditimit është i themeluar në kuader të MF-së. ATK raporton në këtë komitet me anë të një përfaqësuesi. Komiteti i auditimit për vitin 2014 ka mbajtur katër takime, ku janë diskutuar të gjeturat dhe implementimi i rekomandimeve të ATK-së.

NJAB raporton edhe ne Njësinë Qendrore Harmonizuese për auditim të brendshëm me anë të raporteve tremujore.

Në planin vjetor janë paraparë dhjetë (10) auditime të rregullta si dhe auditime sipas kërkesës së menaxhmentit. Plani i auditimit është i bazuar në bazë të identifikimit të nevojave përballë rrezikut më të lartë. NJAB ka operuar në bazë të planit, por ka ngecje në realizimin e tij.

Çështja 17 - Njësia e auditimit nuk e kishte realizuar planin për vitin 2014 - Prioritet i lartë

E gjetura Njësia e auditimit të brendshëm ka realizuar tetë nga 10 auditimet e planifikuara. Po ashtu, kishte kryer edhe një auditim me kërkesë. Auditimet e planifikuara të cilat nuk janë realizuar gjatë vitit 2014 janë auditimi: sektori i programerëve dhe zyra ligjore.

Rreziku Mosrealizimi i planit e rrit rrezikun në ofrimin e sigurisë mbi efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm e që ndikon në efikasitetin e shpenzimit të parasë publike.

Rekomandimi 17 Drejtori i Përgjithshëm duhet të punojë me Drejtorin e NJAB-së për të siguruar përmbushjen e planit. Plani i NJAB-së duhet të monitorohet në baza mujore dhe të ndërmerren veprime proaktive, në mënyrë që devijimet nga plani të adresohen në kohën e duhur.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZAP

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë anomali materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë anomali materiale. Auditorët mund të japin tre lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- Natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë anomali materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë anomali materiale; dhe
- Gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se anomalitë, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban anomali materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i Theksimit të Çështjes duhet:

- Të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- Të ketë titullin 'Theksim i Çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- Të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç' pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen;
- Të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Rekomandimet e vitit paraprak

Komponenti i Auditimit	Rekomandimet e dhëna	Rekomandimet plotësisht të adresuara	Rekomandimet pjesërisht të adresuara	Rekomandimet e pa adresuara
3 Rekomandimet e vitit paraprak (2012)	<p>Çështja - Adresimi i rekomandimit të vitit paraprak – Prioritet i lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit është rishikuar duke i marr parasysh masat e ndërmarra në vitin 2014 dhe të përcaktojë saktë afatet kohore për adresimin e rekomandimit nga AP. Zbatimi i planit duhet të rishikohet nga ATK në baza tremujore.</p>		X	
4.2 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	<p>Çështja - Ekzekutim i ultë i buxhetit në kategorinë e Investimeve Kapitale- Prioritet i lartë</p> <p>Përgatitja e buxhetit për investime kapitale të paraprihet nga një proces rigoroz i vlerësimit që pasqyron të gjitha informatat relevante përfshirë realizimin në vitet e mëparshme / dhe ndryshimet e pritura të vitit. Performanca buxhetore në këtë kategori duhet të monitorohet në baza mujore dhe pengesat për nivelet e planifikuara të ekzekutimit të buxhetit të identifikohen dhe adresohen me kohë.</p> <p>Çështja - Pagesa e pagave nga programet e tjera të MF-së - Prioritet i lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj bashkëpunim më të mirë me Ministrin e Financave për ndarjen buxhetore për paga dhe mëditje dhe gjatë diskutimit të marrë në konsideratë nevojat reale të ATK-së. Financimi i pagave duhet të bëhet në mënyrë transparente.</p>			<p>X</p> <p>X</p>

<p>4.3 Të hyrat (përfshirë të hyrat vetanake)</p>	<p>Çështja - Realizim i ultë i planit të Kontrolleve - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që realizimi i kontrolleve bëhet në përputhje me planin e aprovuar ose në të kundërtën të rishikohen planet e kontrolleve.</p> <p>Çështja - Vonesa në shqyrtimin e Rimbursimeve - Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm të përforcoj kontrollet për të siguruar se çdo kërkesë për rimbursim shqyrtohet brenda afatit të përcaktuar kohor me qëllim të shmangies se vonesave të panevojshme, ndëshkimeve dhe interesave eventuale.</p> <p>Çështja - Mos aplikimi i urdhër-vjeljeve për mbledhjen e borxheve-Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që urdhër-vjeljet dhe bllokimi i llogarive bankare të jenë të vazhdueshme dhe aplikueshme në Thesar dhe autoritete tjera publike.</p> <p>Çështja - Mangësi në marrëveshjet e pagesave me këste të Obligimeve Tatimore-Prioritet i lartë. Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjitha marrëveshjet për pagesa të borxheve me këste të procesohen vetëm përmes Modullit të Detyrimeve në SIGTAS; më tutje Monitorimi i përmbushjes së obligimeve që dalin nga marrëveshjet për pagesa të obligimeve me këste duhet të rritet.</p>	<p>X</p>	<p>X</p> <p>X</p> <p>X</p>	
---	---	----------	----------------------------	--

4.4.1 Prokurimi	<p>Çështja - Nënshkrimi i kontratave pa mjete të zotuar - Prioritet i lartë</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet fillimisht të siguroj se janë zotuar fondet buxhetore për projektet, në mënyrë që ato të mund të realizohen me kohë dhe në linjë me kontratat.</p> <p>Çështja -Vonesa ne ekzekutimin e pagesave ndaj Operatorëve Ekonomik- prioritet i mesëm</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj mbikëqyrje të vazhdueshme të procesit të ekzekutimit të buxhetit, me qëllim që çdo faturë të paguhet brenda afatit të përcaktuar.</p> <p>Çështja - Shpenzimet e telefonisë mobile pa kontratë- prioritet i mesëm</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm të shqyrtoj mundësinë e zhvillimit të procedurave të prokurimit për shpenzimet e telefonisë mobile në mënyrë që të siguroj shërbime efikase dhe vlerë të parasë.</p>	X		X
4.4.3 Kompensimet (pagat dhe mëditjet)	<p>Çështja - Mos harmonizim i emërimeve (pozitive) në kontrata të punës me pozitë në sistemin e pagave - Prioritet i mesëm</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i vlerësojë në mënyrë sistematike arsyet e ndryshimeve mes pozitive në kontratat e punës dhe sistemit të pagave për të siguruar harmonizimin e pozitive.</p>			X
4.5.1 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	<p>Çështja - Mungesa e Udhëzimit të Brendshëm mbi Inventarizim të Pasurisë- Prioritet i mesëm</p> <p>Drejtori i Përgjithshëm duhet të hartoj udhëzimin e brendshëm për inventarizimin e pasurisë duke vepruar në përputhje me Rregullen e MF-Nr 02/2013.</p>			X

4.5.3 Trajtimi i të arkëtueshmeve	Çështja - Nivel i lartë i borxheve të pa mbledhshme -Prioritet i lartë Drejtori i Përgjithshëm duhet të marrë masa adekuate dhe konkrete për mbledhjen borxheve me qëllim që mos të hyn në fazën kritike apo tejkallim të periudhës 6 vite. Në rastet kur është dokumentuar se janë marrë të gjitha masat ligjore për mbledhjen e borxhit brenda periudhës së përcaktuar kohore dhe borxhet nuk janë mbledhur, atëherë këto borxhe të trajtohen si të pa arkëtuara.			X
-----------------------------------	---	--	--	---